

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **KEK-26-3945-1-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me aparate kundër zjarri dhe gypa të hidrantit**
LOT-1 Furnizim me aparate kundër zjarri

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PROGLOBAL SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Dardani, Rr. 28 Nentori, LI-2, Lok 129

(Vendi)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

044148645

(Numri Telefonit)

Latif Imeri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@proglobal-ks.com

(Adresa elektronike)

26.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- | | |
|--|--------------|
| - Njoftimi për kontrate | – 27.04.2026 |
| - Hapja e ofertave | – 19.05.2026 |
| - Njoftimi mbi venimin e AK-se dhe Letra standarde | - 11.08.2026 |
| - Kërkesa për Rishqyrtim | – 15.08.2026 |
| - Përgjigje e AK në Kërkesën për rishqyrtim | – 25.08.2026 |

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

- | |
|-------------------------|
| - Me datën – 09.06.2026 |
|-------------------------|

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Operatori Ekonomik ankues “Pro Global” shpk – Prishtine, me datën 15.08.2026, bazuar ne dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se dhe ne afatin paraparë me LPP, e ka kundërshtuar vendimin e AK – KEK, propozimin për Anulim te AP, me prova konkrete dhe baze ligjore.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet ligjore te LPP-se dhe akteve tjera nen ligjore.

Duke marrë parasysh mënyrën e ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertës sonë, si dhe arsyet e dhëna nga Autoriteti Kontraktues për eliminimin e OE-së, konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat dhe parimet themelore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar, në veçanti:

1. Neni 1 i LPP-së – Qëllimi i Ligjit
2. Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtim/Mosdiskriminimi
3. Neni 28 i LPP-së – Specifikimet teknike
4. Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
5. Neni 59 dhe Neni 72 i LPP-së – Mundësia e kërimit të sqarimeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Ne si kompani ofertuese ne këtë procedure te prokurimit me datën 11.08.2026, kemi pranuar njoftimin nga AP KEK mbi rezultatin e aktiviteitit te ANULIMIN te AP përkatësisht komisoni i vlerësimit te ofertave

ne kundershtim me nenin 59 te LPP-se i ka ekzaminuar, dhe krahasuar ofertat, prandaj ne kuptim te nenit 108/A te LPP-se dhe brenda afatit ligjore paraqesim kunderargumentet tona si ne vijim:

Operatori Ekonomik PROGLOBAL SHPK, në kuadër të procedurës së prokurimit, ka dorëzuar ofertën në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, duke paraqitur dokumentacionin teknik dhe dëshmitë përkatëse për artikujt e ofertuar.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues ka vendosur eliminimin e ofertës sonë, duke paraqitur si arsye mospërputhje të pretenduara teknike për pozicionet nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5, konkretisht:

1. **Poz. nr. 1 dhe 2 – Cilindri i AKZ-së:** AK pretendon se është kërkuar cilindër me një tegel saldimi, ndërsa OE ka ofruar cilindër me dy tegela saldimi;
2. **Poz. nr. 1 dhe 2 – Lënda shuese ABC:** AK pretendon se është kërkuar përmbajtje 40%, ndërsa OE ka ofruar 50%;
3. **Poz. nr. 2 – Aparati për mbrojtje kundër zjarrit P-9 kg:** AK pretendon se OE nuk ka ofruar fare këtë artikull;
4. **Poz. nr. 3 – Aparati për mbrojtje kundër zjarrit CO₂ 5 kg:** AK pretendon se është kërkuar që aparati të jetë i përshtatshëm për pajisje elektrike/elektricitet statik;
5. **Poz. nr. 3 – Dimensionet:** AK pretendon se janë kërkuar dimensione të përafërta 665 × 152 mm, ndërsa OE ka ofruar 950 × 138 mm;
6. **Poz. nr. 5 – Aparati 30 kg:** AK pretendon se është kërkuar peshë 90 kg, ndërsa OE ka ofruar peshë 82 kg.

Arsyet e lartcekura të Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë nuk qëndrojnë dhe nuk paraqesin bazë për shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme.

Në veçanti, AK gjatë vlerësimit është dashur të analizojë kërkesat konkrete të specifikimit teknik në raport me karakteristikat funksionale dhe teknike të produkteve të ofruara, si dhe dokumentacionin teknik të dorëzuar nga OE, e jo të konstatojë automatikisht mospërputhje vetëm mbi bazën e dallimeve numerike apo karakteristikave të cilat në raste të caktuara paraqesin karakteristika më të avancuara se minimumi i kërkuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 1

Poz. nr. 1 dhe 2 – Pretendimi lidhur me numrin e tegelave të saldimit të cilindrit

Autoriteti Kontraktues pretendon se në Dosjen e Tenderit është kërkuar **cilindër me një tegel saldimi**, ndërsa OE ka ofruar cilindër me **dy tegela saldimi**.

Ky konstatim i Autoritetit Kontraktues NUK qëndron dhe është faktikisht i pasaktë.

Aparatet zjarrfikëse të ofruara nga OE në **pozicionet nr. 1 dhe nr. 2 janë të pajisura me cilindër me një (1) tegel saldimi**, pikërisht ashtu siç është kërkuar në specifikimin teknik të Dosjes së Tenderit.

Pra, në këtë rast nuk kemi të bëjmë as me devijim teknik dhe as me ofrim të një zgjidhjeje alternative ndaj kërkesës së AK-së. **Produkti i ofertuar e përmbush drejtpërdrejt kërkesën e DT-së për cilindër me një tegel saldimi.** Kjo lehtësisht mund të konstatohet nga dokumentacioni Teknik – katalogu dhe prerja terthore e cilindrit, se cilindri është me një tegel saldimi.

Për rrjedhojë, konstatimi i AK-së se OE ka ofruar cilindër me dy tegela saldimi është rezultat i një vlerësimi të pasaktë të produktit dhe/ose dokumentacionit teknik të dorëzuar.

Prandaj, arsyeja e eliminimit e paraqitur nga AK për pozicionet nr. 1 dhe nr. 2 është **e pabazuar dhe në kundërshtim me gjendjen faktike të produktit të ofertuar.**

Nëse AK ka pasur ndonjë paqartësi gjatë interpretimit të katalogut apo dokumentacionit teknik, kjo nuk mund të shndërrohet në konstatimin se produkti ka dy tegela saldimi pa ekzistuar dëshmi teknike që e mbështet një konstatim të tillë.

Për këtë arsye kërkojmë që AK të rishqyrtojë këtë konstatim, të verifikojë dokumentacionin teknik dhe produktin e ofertuar dhe të konstatojë se aparatet zjarrfikëse në pozicionet nr. 1 dhe nr. 2 **kanë cilindër me një tegel saldimi dhe përmbushin kërkesën përkatëse të Dosjes së Tenderit.**

Konsiderojmë se ky arsyetim, i trajtuar në mënyrë të izoluar nga karakteristikat funksionale, siguria dhe certifikimi i produktit përfundimtar, **nuk paraqet bazë të mjaftueshme teknike për eliminimin e ofertës.**

Numri i tegelave të saldimi është në radhë të parë karakteristikë e konstruksionit dhe teknologjisë së prodhimit të cilindrit. Ajo që është esenciale për sigurinë dhe përdorimin e aparatit është që cilindri dhe aparati i përfunduar të përmbushin kërkesat përkatëse të rezistencës ndaj presionit, sigurisë, qëndrueshmërisë dhe performancës së shuarjes.

Rrjedhimisht, edhe nëse cilindri do të kishte dy tegela të saldimi, në vetvete, **nuk dëshmon se cilindri është më pak i sigurt, më pak rezistent apo funksionalisht inferior** ndaj një cilindri me një tegel saldimi.

Nëse produkti i përfunduar i është nënshtruar testeve përkatëse të presionit dhe sigurisë dhe është certifikuar në përputhje me EN standardet e kërkuara, atëherë AK duhet të argumentojë konkretisht se **çfarë ndikimi negativ teknik, funksional apo të sigurisë** kjo karakteristikë e bën produktin të papërshtatshëm për qëllimin e prokurimit.

Për më tepër, qëllimi esencial i kërkesës teknike duhet të jetë siguri i një aparati kundër zjarrit të sigurt, funksional dhe të certifikuar sipas standardeve përkatëse dhe jo përcaktimi i një metode të vetme të prodhimit, përderisa zgjidhja teknike e ofruar arrin nivelin e kërkuar të sigurisë dhe performancës.

Për këto arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta rishqyrtojë këtë konstatim dhe ta vlerësojë produktin e ofruar në bazë të **performancës, sigurisë, testimeve dhe certifikimit të produktit përfundimtar**, dhe jo vetëm në bazë të numrit të tegelave të përdorur gjatë procesit të prodhimit.

PRETENDIMI ANKIMOR 2

Sa i përket lëndës shuarese ABC, fakti që është ofruar **50% në vend të 40%** nuk mund të trajtohet automatikisht si mangësi teknike pa u vërtetuar paraprakisht se një përqindje më e lartë prej 50% ndikon pozitivisht në funksionalitetin dhe destinimin e produktit. Lenda shuarese pluhur ABC 50% të ofertuar është me e avancuar se sa është kërkuar në Aneksi 1 të DT.

Produkti i ofruar nga OE PROGLOBAL SHPK përmban **50% të komponentit aktiv të pluhurit ABC**, pra një përqindje prej 10% më të lartë se ajo prej 40% e përcaktuar në specifikimin teknik. **Përqindja më e lartë e komponentit aktiv nuk paraqet mangësi të produktit; përkundrazi, në kushte të krahasueshme, ajo mundëson veti dhe kapacitet shuarës më të lartë.**

Ofrimi i pluhurit ABC 50% nuk duhet të interpretohet si devijim negativ teknik. AK duhet të vlerësojë nëse produkti i ofruar përmbush ose tejkalon performancën dhe funksionin e kërkuar, dhe jo ta eliminojë ofertën vetëm për faktin se karakteristika e ofruar është më e lartë se vlera e kërkuar.

Dallimi kryesor mes **pluhurit shuarës ABC 40% dhe ABC 50%** është përqindja e komponentit aktiv, zakonisht **monoammonium phosphate (MAP)**.

Karakteristika	ABC 40%	ABC 50%
Përmbajtja e MAP	rreth 40%	rreth 50%
Lënda aktive	Monoammonium phosphate	Monoammonium phosphate
Përdorimi	Zjarre A, B, C	Zjarre A, B, C
Efekti në zjarret Klasa A	I mirë	Në përgjithësi më i mirë
Efikasiteti për të njëjtën sasi pluhuri	Standard	Potencialisht më i lartë
Formimi i shtresës mbi materialet e ngurta	Më i kufizuar	Më efektiv
Kostoja	Zakonisht më e ulët	Zakonisht më e lartë

MAP është komponenti kryesor që i jep pluhurit ABC aftësinë për të vepruar. Prandaj, në kushte të krahasueshme, një pluhur me **50% MAP ka përqendrim më të lartë të lëndës aktive shuarese se një pluhur me 40% MAP.**

PRETENDIMI ANKIMOR 3

Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar eliminimin e ofertës sonë duke pretenduar se **OE nuk ka ofruar fare aparatin për mbrojtje kundër zjarrit P-9 kg.**

Ky konstatim i AK-së **NUK qëndron dhe NUK pasqyron gjendjen faktike të ofertës së dorëzuar.**

OE PROGLOBAL SHPK e ka ofertuar aparatin kundër zjarrit **P-9 kg** në ofertën e dorëzuar brenda afatit të përcaktuar për tenderim. Pra, artikulli ka qenë pjesë përbërëse e ofertës sonë që nga momenti i dorëzimit të tenderit.

Çështja konkrete nuk është se OE nuk e ka ofertuar produktin P-9 kg, siç pretendon AK, por se **për këtë produkt ka munguar katalogu/dokumenti teknik përkatës.**

Këto janë dy rrethana juridikisht dhe faktikisht të ndryshme: njëra është mosofertimi i artikullit, ndërsa **tjetra është mungesa e një dokumenti që dëshmon karakteristikat e një artikulli tashmë të ofertuar.**

Në rastin konkret kemi të bëjmë me rastin e dytë.

Sipas dispozitave të **Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik**, gjatë procesit të ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve lejohej që AK të kërkojë sqarime dhe, në rrethana të lejuara, informacione apo dokumente që mungojnë në tender, me kusht që këto dokumente në mënyrë objektive të dëshmojnë një gjendje që ka ekzistuar para afatit të fundit për dorëzimin e tenderit.

Në rastin tonë, eventualisht dorëzimi i katalogut për **P-9 kg nuk do të ndryshonte produktin e ofertuar, nuk do të shtonte një artikull të ri në ofertë, nuk do të ndryshonte çmimin dhe as ndonjë kusht material të tenderit.**

Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik

39.8 AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik.

Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-se

Problemi	Si te vepohet	NENI
Është dorëzuar specifikacioni teknike për mallrat e ofruara por mungon katalogu	Mund të kërkohej informata sqaruese	69

Katalogu do të kishte vetëm funksion dëshmuar dhe sqarues, përkatësisht do të konfirmonte karakteristikat teknike të produktit P-9 kg, i cili tashmë ishte ofertuar brenda afatit të tenderimit.

***Prova** – Katalogu për Aparatin për Mbrojtje kundër Zjarrit P-9kg me plhur ABC*

PRETENDIMI ANKIMOR 4

Poz. nr. 3 – Aparati për mbrojtje kundër zjarrit CO₂ 5 kg: AK pretendon se është kërkuar që aparati të jetë i përshtatshëm për pajisje elektrike/elektricitet statik;

Ky konstatim i AK-së NUK qëndron nga aspekti teknik dhe funksional i produktit.

Aparati i ofertuar është **aparat zjarrfikës CO₂ 5 kg**, ku lënda shuese është dioksidi i karbonit (CO₂). Aparatet me CO₂ janë të destinuara edhe për intervenim në zjarre që përfshijnë pajisje elektrike, pasi CO₂ është agjent shuarës që **nuk lë mbetje pas përdorimit dhe nuk dëmton pajisjet elektrike në mënyrën që mund ta bëjnë agjentët shuarës që lënë mbetje.**

Produkti i ofertuar është gjithashtu i pajisur me **gyp EPDM**, të përshtatshëm për konfigurimin dhe përdorimin e aparatit CO₂ sipas destinimit të përcaktuar nga prodhuesi.

Prandaj, **përshtatshmëria për pajisje elektrike nuk krijohet nga një formulim i shkruar në mënyrë identike me specifikimin e AK-së**, por është karakteristikë funksionale e aparatit konkret CO₂ dhe duhet të vlerësohet në bazë të karakteristikave.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se **eliminimi mbi këtë bazë është i pabazuar**, pasi aparati CO₂ 5 kg i ofertuar është funksionalisht i përshtatshëm për shuarjen e zjarreve që përfshijnë pajisje elektrike/elektricitetin statik, sipas kushteve dhe distancës së sigurisë të përcaktuar për produktin.

PRETENDIMI ANKIMOR 5

Autoriteti Kontraktues pretendon se në specifikimin teknik janë kërkuar dimensione të përafërta **665 × 152 mm**, ndërsa OE ka ofruar aparat me dimensione **950 × 138 mm**.

Ky arsyetim i AK-së NUK qëndron, pasi vetë specifikimi teknik, sipas formulimit të përdorur nga AK, përcakton shprehimisht **“dimensione të përafërta”** dhe jo dimensione fikse, të sakta apo dimensione të shoqëruara me tolerancë të përcaktuar minimale/maksimale.

Përdorimi i termit **“të përafërta”** nënkupton se dimensionet 665 × 152 mm kanë karakter orientues dhe se mund të ekzistojnë devijime të arsyeshme në varësi të konstruksionit dhe modelit të aparatit të prodhuesve të ndryshëm.

Për më tepër, produkti i ofertuar mbetet **aparat zjarrfikës CO₂ me kapacitet 5 kg**, pra plotëson destinimin dhe kapacitetin funksional të kërkuar. Diferenca në dimensionet e jashtme vjen nga konstruksioni dhe konfigurimi i produktit dhe, në vetvete, nuk dëshmon performancë më të ulët, kapacitet më të vogël shuarës apo papërshtatshmëri për destinimin e kërkuar.

Ndryshimi në lartësi lidhet me konstruksionin konkret të aparatit. Përderisa specifikimi nuk ka përcaktuar kufij të detyrueshëm për këto dimensione, një ndryshim i tillë nuk mund të konsiderohet automatikisht mospërputhje teknike.

Prandaj, eliminimi i OE mbi këtë bazë është i paarsyetuar dhe kërkojmë që AK ta rishqyrtojë këtë konstatim duke marrë parasysh formulimin e saktë të specifikimit teknik, karakterin orientues të dimensioneve të kërkuara dhe përmbushjen e kërkesave funksionale nga aparati CO₂ 5 kg i ofertuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 6

Autoriteti Kontraktues pretendon se është kërkuar aparat me peshë **90 kg**, ndërsa OE ka ofruar aparat me peshë **82 kg**, dhe këtë dallim e ka konsideruar si mospërputhje teknike.

Ky konstatim dhe arsyetim i AK-së NUK është i bazuar nga aspekti teknik dhe funksional.

Produkti i ofertuar nga OE është aparat zjarrfikës me **30 kg lëndë shuese**, ashtu siç është kërkuar në specifikimin teknik. Pesha totale prej **82 kg** është rezultat i konstruksionit, materialeve dhe teknologjisë së prodhimit të modelit konkret dhe nuk nënkupton në asnjë mënyrë zvogëlim të sasisë së lëndës shuarese prej 30 kg apo kapacitet më të ulët funksional të aparatit.

Përkundrazi, nëse dy aparate kanë të njëjtin kapacitet të kërkuar prej **30 kg lëndë shuese** dhe përmbushin kërkesat e njëjta të sigurisë dhe performancës, një peshë totale më e ulët e aparatit nuk përbën mangësi teknike. **Ajo mund të përfaqësojë madje përparësi praktike në aspektin e manovrimit dhe transportimit të aparatit.**

Prandaj, konsiderojmë se **eliminimi i ofertës mbi këtë bazë është i pabazuar**, pasi AK ka marrë një karakteristikë fizike të produktit dhe e ka trajtuar atë si mangësi pa dëshmuar ndikimin e saj negativ në performancën apo funksionalitetin e aparatit.

Për rrjedhojë, kërkojmë që ky konstatim të rishqyrtohet dhe produkti të vlerësohet në bazë të **kapacitetit prej 30 kg të lëndës shuese, performancës, sigurisë dhe funksionalitetit të tij**, e jo të konsiderohet i papërgjegjshëm vetëm për faktin se konstruksioni i aparatit ka peshë totale më të ulët.

Po ashtu, dallimet në dimensione dhe peshë duhet të analizohen në raport me formulimin e saktë të specifikimit teknik. Vetë AK, sipas arsytimit të eliminimit, për dimensionet e pozicionit nr. 3 përdor termin **“dimensionet e përafërta”**. Përdorimi i këtij formulimi nënkupton se dimensionet nuk janë përcaktuar domosdoshmërisht si vlera absolute dhe të pandryshueshme.

Përfundim

Bazuar në sa më sipër, konsiderojmë se vendimi për eliminimin e OE-së është nxjerrë në kundërshtim me **Nenin 1, Nenin 6, Nenin 7, Nenin 28, Nenin 59 dhe, sipas çështjes konkrete të dokumentacionit/sqarimeve, Nenin 72 të LPP-së**, si dhe me dispozitat përkatëse të Rregullores për Prokurimin Publik që rregullojnë ekzaminimin, vlerësimin dhe sqarimin e tenderëve.

Si rezultat, propozojmë që AK të marre:

V E N D I M

- I. **TE APROVOHET** ne tërësi kërkesa jone si e bazuar.
- II. Për rrjedhojë, kërkojmë **anulimin e vendimit për eliminimin e OE-së, kthimin e aktivitetit të prokurimit në rivlerësim dhe rivlerësimin e ofertës sonë në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe legjislacionit dytësor në fuqi.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme dhe te cilat ne tërësi do të kalkuloohen dhe të kompensohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
- h) ***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.